



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:236417

Datë: 27.01.2025

Numri i dokumentit: 06760882

P.nr.295/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.S. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1576/23 e datës 08.10.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 23.01.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Klodina Gashi, i dëmtuari M.B., mbrojtësi sipas detyrës zyrtare për të pandehurin av.Naser Azemi dhe i pandehuri L.S., më datën 23.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.01.2025 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.S. nga i ati F..., e ëma S..., e gjinisë H..., data e lindjes... në fshatin ..., ku edhe tani jeton, komuna e Vushtrrisë me numër personal ..., ka të kryer shkollën e fillore, punon në mobilierinë "...", i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar.

### ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 08.06.2023 rreth orës 18:11 minuta, në fshatin Kollë, komuna e Vushtrrisë, saktësisht në malet e Qyqavicës, seriozisht e ka me fjalë personin zyrtar në lidhje me punën, të dëmtuarin-rojën e pyllit M.B., në atë mënyrë që derisa i pandehuri kishte qenë në pyllin pronë shtetëror, me traktor "Ferguson", dhe kishte prerë një sasi prej 1.60 metër kub dru të llojit ahu dhe shkozë, në ato momente kishte shkuar roja e pyllit tani i dëmtuari pasi e kishte pyetur të njëjtin "pse kishte ardhur në pyll dhe a e din se është e ndaluar", në ato momente i ishte drejtuar me fjalët kërcënuese "ti mi ke shkrua tri-katër dënime, sot nuk guxon me më shkrua dënime më,

as me mi marr drutë, se pastaj ki punë me mu, veç mos dalsh në qytet nesër hiq se bukë nuk ki me hangër ma”, me të cilat veprime ka shkaktuar tek i dëmtuari ndjenjën e frikës për jetë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 181 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 460 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

TË PANDEHURIT: L.S.: i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Pala e dëmtuar M.B. ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PPII.nr.1576/23 e datës 08.10.2024, kundër të pandehurit L.S. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 të KPRKsë.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 23.01.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri L.S. ka deklaruar se e pranon fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë, i premtion gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më dhe njëherit i kërkon falje të dëmtuarit.

### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se është e pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, si dhe rrethanat e tjera të përcaktuara si në aktakuzë.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështetë fjalën e prokurorit të shtetit dhe njëherit heq dorë nga kompensimi i demit lidhur me këtë çështje penale.

Avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare lidhur me pranimin e fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit numër të rastit 2023-BD-457, i datës 08.06.2023, raporti i oficerit, i datës 08.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin-dëshmitarin M.B., i datës 08.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i dëshmitarit Q.Q., i datës 08.06.2023, procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit L.S., i datës 07.02.2024, procesverbali me nr.000831 mbi konfiskimin e asortimenteve pyjore, i datës 08.06.2023, dhe foto dokumentacioni në shtojcë prej 3 fotografive.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.3 e lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 181 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Kanosje e kryen “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj*”. Ndërsa në par.3 është përcaktuar se “*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRKsë, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, kërkim faljen që i'a ka bërë të dëmtuarit ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur shkallën e rrezikshmërisë shoqërore që paraqitë kjo vepër penale dhe atë ndaj rojës së pyllit i cili ka përgjegjësinë për ruajtjen e pyllit, faktin se ka qenë edhe më parë i dënuar e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.193/2023 i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 01.08.2023, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri për veprën penale Vjedhja e Pyllit.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti për veprën e lartcekur, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest të rregullt civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së, pasi që pala e dëmtuar ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.295/2024,  
datë 27.01.2025

**GJYQTARI**  
Agron Maxhuni

Numri i lëndës: 2023:236417  
Datë: 27.01.2025  
Numri i dokumentit: 06760882

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.